



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 63/4 Prot.

Tiranë, më 7/12 /2017

REKOMANDIM

Nr. 01, datë 7/12 /2017

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe neneve 77-112 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave në ngarkim të kontrolluesit "**Drejtoria Arsimore Rajonale Fier**", Fier.

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit nr. 10, datë 12.01.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "**Drejtoria Arsimore Rajonale Fier**", me objekt:

- Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga personi me initiale M.R, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale në përmbajtje të dëftesës së shkollës së mesme, të bërë publike në një portal online, në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar;

Hetimi administrativ pranë kontrolluesit është iniciuar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga shtetasi me initiale M.R, që pretendonte se në portalin Pasqyra.al ishte publikuar dëftesa e shkollës së mesme (që përmban të dhëna personale). Ankesa drejtohej ndaj institucioneve arsimore. Në këtë kuadër, ankuesi ka pretenduar shkelje të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Pala ankuese ka paraqitur në cilësinë e provës artikullin e publikuar në portalin Pasqyra.al që përmban edhe dëftesën e shkollës së mesme.

Kontrolluesi "**Drejtoria Arsimore Rajonale Fier**", është kontrollues publik që ushtron aktivitet publik në fushën arsimit parauniversitar, në zbatim të Ligjit 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" dhe në këtë kuadër, edhe nëpërmjet institucioneve të tjera arsimore rajonale në varësi të saj, përpunon të dhëna personale për kategorinë e subjekteve të të dhënave "nxënës" por edhe për "punonjësit". Kontrolluesi i përpunon të dhënat në mënyrë manuale.

1. Zyra e Komisionerit, në kuadër të trajtimit të ankesës dhe verifikimit të vërtetësisë së publikimit, paraprakisht kërkoi informacion nga ana e kontrolluesit "**Drejtoria Arsimore**

Rajonale Fier” dhe vënien në dispozicion edhe të kopjes së dokumentit të prezumuar si të publikuar.

Në vijim kontrolluesi **“Drejtoria Arsimore Rajonale Fier”**, nëpërmjet përgjigjes nr. 14/1 prot, datë 06.01.2017 referonte bashkëlidhur përgjigjen e Shkollës së Mesme **“Adem Vrapit”** Roskovec (në varësi të saj) nëpërmjet të cilës konfirmohej vërtetësia e dokumentit të publikuar (regjistri i amzës) dhe kopjen e këtij të fundit.

2. Nga analizimi i artikullit të publikuar dhe përmbajtjes së dëftesës së publikuar rezulton që janë bërë publike disa kategori të dhënash personale të ankueses. Gjithashtu është i dukshëm edhe emri i drejtorit të shkollës me iniciale F. B dhe nënshkrimi i tij.

Zyra e Komisionerit paraprakisht vlerëson se publikimi i të dhënave personale pa pëlqimin e subjektit të të dhënave (nxënësit) dhe pa një qëllim të ligjshëm konsiderohet në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave dhe Ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008, **“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”** i ndryshuar.

3. Zyra e Komisionerit gjithashtu vlerëson se **“Drejtoria Arsimore Rajonale Fier”**, në cilësinë e kontrolluesit ka detyrimin që të përcaktojë dhe të miratojë të gjitha masat teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave personale, të cilat duhet të jenë të detyrueshme edhe për të gjitha institucionet në varësi të saj.

Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit, është njohur me procedurat, rregullat, masat e sigurisë dhe konfidencialitetit që aplikohen në rastin e përpunimit të të dhënave personale të nxënësve nga ana e kontrolluesit **“Drejtoria Arsimore Rajonale Fier”**.

Kontrolluesi ka paraqitur në cilësinë e provës disa akte të miratuara prej tij:

- **“Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”;**
- **“Deklaratë Konfidencialiteti”;**
- **“Urdhër nr. 1416, datë 28.06.2016 “Për rregullimin e konstatimeve të inspektimit nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.** Nëpërmjet këtij urdhri është ngritur një grup pune që ka për detyrë informimin dhe trajnimin e DAR/ZA-ve mbi detyrimet ligjore, dhe hartimin e të gjitha akteve në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, **“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”** i ndryshuar.

Pas analizimit të tyre Zyra e Komisionerit vlerëson se aktet janë hartuar në përputhje me standardet e miratuara në kuadër të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, **“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”**, i ndryshuar.

Pavarësisht ekzistencës së këtyre akteve, fakti i publikimit të të dhënave personale në portalin online nënkupton cedim në zbatimin në praktikë të masave të sigurisë dhe konfidencialitetit të të

dhënave nga ana e kontrolluesit DAR Fier dhe institucioneve në varësi të tij, në kundërshtim me nenet 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 (cituar më sipër).

Zbatimi në praktikë i masave të sigurisë dhe konfidencialitetit është i rëndësishëm për kontrolluesin pasi përbën bazën e referimit për çdo përpunim të të dhënave, për çdo punonjës, dhe përcakton standartet ligjore për garantimin e një përpunimi të ligjshëm të të dhënave personale.

Për shkeljet e konstatuara është mbajtur procesverbali i konstatimit në momentin e ushtrimit të hetimit administrativ. Një kopje e procesverbalit iu dorëzua kontrolluesit.

Në përmbajtje të procesverbalit, përfaqësuesi i kontrolluesit, deklaroi se pretendimet do të dërgoheshin zyrtarisht brenda afateve ligjore. Në vijim, kontrolluesi DAR Fier nëpërmjet shkresës nr. 64/1, datë 23.01.2017, paraqiti pretendimet lidhur me hetimin administrativ të ushtruar dhe konstatimet e Zyrës së Komisionerit. Pretendimet konsistojnë në hartimin e akteve përkatëse në kuadër të garantimit të mbrojtjes së të dhënave personale nga DAR Fier por ndër të tjera theksohej fakti që regjistrat e amzës menaxhohen dhe administrohen nga Drejtoritë e Institucioneve Arsimore (në varësi të DAR) referuar nenit 112 të “Dispozitave Normative për Sistemin Arsimor Parauniversitar” (viti 2013), miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Në kuadër të këtyre pretendimeve Zyra e Komisionerit vlerëson se kontrollues në bazë të ligjit nr. 9887 është DAR Fier pasi është ky institucion që përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në varësi të të cilit është dhe institucioni arsimor që administron të dhënat personale të ankuesit. Për pasojë kontrolluesi DAR Fier ka detyrimin për të hartuar aktet përkatëse rregullatore dhe për të siguruar në praktikë zbatimin e tyre, me qëllim mbrojtjen e të dhënave personale.

Sa më sipër:

Në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, neni 31, pika 1, germa a/1,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të merren masa konkrete për zbatimin në praktikë të “Rregullores së brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale”, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave të nxënësve;
2. Në zbatim të nenit 28 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të merren masa konkrete për evidentimin e përgjegjësive të personave që kanë akses në të dhënat personale dhe që kanë nënshkruar “deklaratat e konfidencialitetit”;

3. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në këtë Rekomandim.
4. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky rekomandim u shpall sot më datë 7.2 2017.

